

Thirrje për angazhimin e vëzhguesve për cilësinë e debatit parlamentar

Instituti për Demokraci "Societas Civilis" (IDSCS) shpall thirrje për kandidatë për angazhim me pagesë si vëzhgues të cilësisë së diskutimit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Thirrja është për të diplomuar/magjistra apo studentë të motivuar nga të gjitha fushat shoqërore-humane, analistë dhe aktivistë nga organizata të shoqërisë civile.

Me thirrjen do të përzgjidhet **një vëzhgues / vëzhguese** i/e cili do të trajnohen dhe do të ketë mundësi të marrë pjesë në monitorimin e cilësisë së debateve parlamentare në Kuvendin e Maqedonisë gjatë një periudhe disa mujore në kuadër të Programit Zviceran për Mbështetje Parlamentare (PSP).

Në këtë thirrje IDSCS do të përzgjedhë 1 kandidat/kandidate i/e cili/cila do të trajnohet mbi temën "Bazat e Demokracisë Deliberative (Debatuese) dhe përdorimin e "Indeksit për Cilësinë e Debatit" që do të jetë bazë për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së debatit në komisionet parlamentare dhe seancat plenare.

Angazhimi ditor i vëzhguesve **do të jetë deri në 4 orë** varësisht nga intensiteti dhe kohëzgjatja e debateve parlamentare. **Për këtë angazhim, vëzhguesi/vëzhguesja do të marrë kompensim bruto mujor total prej 334 franga.**

Thirrja do të jetë e hapur për 11 ditë duke filluar nga data 24.06.2022 (e premte) deri më 04.07.2022 (e hënë - ora 23:59).

Aplikantët duhet të paraqesin **biografi të shkurtër dhe letër motivuese** në contact@idscs.org.mk me shënim **"Programi Zviceran për Mbështetje Parlamentare- vëzhgues/vëzhguese"**. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh. Nëse ka interes të madh, IDSCS do të ftojë kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë për intervistë.

Programi për Mbështetje Parlamentare (PSP), mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbytja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.

implemented by: